

Newsletter Bota e SIGAL UNIQA



Botimi për muajin qershor 2024



"SIGAL fpcHealth"

Aplikacioni i dëmeve të shëndetit, risi për tregjet e sigurimeve në Shqipëri por edhe ndërkombtarsisht.

Shkarkoni aplikacionin



PËRMBAJTJA

Humbi jetën në minierë, SIGAL UNIQA dëmshpërblen familjen me 60 milionë lekë/ Ponari-bizneseve: Siguroni punonjësit tuaj!

Takimi me përfaqësues të “UN Women” në Shqipëri/ SIGAL UNIQA, e para kompani sigurimi që firmos “Parimet e Fuqizimit të Grave”

Shtimi i sëmundjeve kancerogjene/ Ponari: Me SIGAL UNIQA, shërbime në klinikat dhe spitalet më të mira në botë

SIGAL UNIQA, më e madhja dhe më e besuara kompani sigurimi edhe për 5-mujorin 2024

Pensionet private pranë kufirit të 40 mijë anëtarëve/ “SIGAL UNIQA Fond Pensioni”, më i madhi sa i përket aseteve neto

SIGAL UNIQA – Kosovë, lidere e tregut të sigurimeve edhe për 5-mujorin 2024

MAQEDONIA E VERIUT
90 milionë Euro prime në 5 muaj/ Sigurimet jo-jetë në Maqedoninë e Veriut rriten me 10%. Sigurimi privat i shëndetit, më popullori

UNIQA Insurance Group
Pikë historike për “UNIQA”/ Mbi 1 miliard Euro prime në sigurimin e korporatave në Europë

‘Spitali vjen tek ju’/ SIGAL UNIQA i mundëson mbi 500 punonjësve të kompanisë në Tiranë kryerjen e Check Up-it në ambjentet e punës

SIGAL UNIQA, pjesë e Panairit të Parë dedikuar Real Estate-t

Më shumë se një kompani sigurimit

FOTO/ Mjedis i pastër, shoqëri e shëndetshme. SIGAL UNIQA, aksion edhe në bregdet

KOSOVE / Dita Botërore e Mjedisit

Jetojmë më mirë së bashku

SIGAL UNIQA Group Austria është sot një kompani me standarte tërësisht europiane, e cila i shërben me përkushtim klientëve, qytetarëve, komunitetit, u shërben atyre me të cilët ne shkëmbehem në rrugë, atyre që sapo dalim nga shtëpia dhe u themi mirëmëngjes, atyre me të cilët ndajmë jetën në qytet, atyre me të cilët ndajmë vlerat dhe jetën tonë të përditshme.

Çdo ditë SIGAL UNIQA punon, rritet, ecën përpara, zgjeron partnerët, stafi n me qëllimin e vetëm: ofrimin e një shërbimi sa më profesional ndaj klientëve që jetën, shëndetin, pronën, automjetin dhe pensionin privat ia besojnë pikërisht kësaj kompanie. Sepse çdo klient i SIGAL UNIQA, i vogël apo i madh, është pjesë e një familjeje të madhe që sot numëron mbi 1 milion anëtarë.

Sigurimi i Shtëpisë, Apartamentit

Mbroni investimin tuaj më të rëndësishëm: shtëpi, banesë, apartament nga zjarri dhe katastrofat natyrore.



Për vetëm
1 Euro/m²
në vit

Pse të zgjidhni sigurimin e shtëpisë dhe apartamentit tek SIGAL UNIQA?

SIGAL UNIQA është kompania më e madhe e sigurimeve në Shqipëri.

Për më tepër, SIGAL UNIQA ofron edhe shërbimin e asistencës 24 orë, që do t'ju ndihmojë në rastin e një emergjence. Kjo do t'ju japë një ndjenjë të sigurisë dhe do të reduktojë stresin në rastin e një situatë emergjente.

Rreziqet e Siguruara	Paketa Standard	Paketa Silver
Zjarri	✓	✓
Rrufe	✓	✓
Eksplizion	✓	✓
Përplasjes ose rënies së një avioni, pjesëve ose ngarkesës së tij	✓	✓
Përpjekjeve për shuarjen e zjarrit, prishjeve ose lëvizjeve në lidhje me cdo njerën prej ngjarjeve të mësipërme në përputhje me kufirin e përcaktuar në Policë	✓	✓
Tërmeti		✓

Mbulim Shtesë Sigurimi i Përgjegjësishë ndaj komshiut

Ky sigurim ju mbulon dëmet që mund të shkaktoni aksidentalisht në pronën e komshiut.

Sigurimi i shtëpisë plus Teleshëndet

Nëse bleni këtë siguracion me prim duke nisur nga 130 euro përfitoni falas edhe shërbimin novator "TeleShëndet".



Blije online
duke skanuar barkodin

Produkti
më i
shitur



rritemi më mirë së bashku

Ngjarjet kryesore

Humbi jetën në minierë, SIGAL UNIQA dëmshpërblen familjen me 60 milionë lekë/ Ponari-bizneseve: Siguroni punonjësit tuaj!



Aksidentet janë bërë sot pjesë e përditshmërisë sonë. Çdo ditë, në çdo cep të Shqipërisë, dëgjojmë për aksidente të ndryshme me pasojë për jetën e njeriut. Kjo për shkak të pakujdesive por edhe për shkak të ritmeve të zhvillimeve ekonomike, që po rriten ditë pas dite, kryesisht në sektorë si ndërtimi apo minierat.

I tillë ishte edhe aksidenti fatal në Minierën e Thekënit në Martanesh, të martën e 21 Majit, ku si pasojë e një aksidenti në galeri humbi jetën 29-vjeçari Armond Peshku.

Kompania ku punonte i riu i kishte siguruar punonjësit e saj pikërisht pranë “SIGAL UNIQA Group Austria”, konform ligjit Nr.1109, datë 30.7.2008 “PËR SIGURIMIN PUNONJËSVE, TË PUNËSUAR NË VEPRIMTARINË MINERARE, NGA AKSIDENTET NË PUNË”.

Për ti shprehur ngushëllimet familjes dhe për të përmbushur një detyrim kontraktual të kompanisë që ai drejton, dëmshpërblimin prej 60 milionë Lekësh, familjen Peshku në Martanesh e vizitoi edhe CEO i “SIGAL UNIQA Group Austria”, z. Avni Ponari.

“Ne përmbushëm një detyrim sot. Sepse

kompania ku djali i tyre punonte, kishte bërë sigurimin e punonjësve të të gjithë minierës. Çka bëri të mundur që, ne, menjëherë pas njoftimit, nuk pritëm asgjë më tepër, për ti ardhur në ndihmë familjes. Familjes natyrisht që nuk mund tu kthejmë të afërmin e tyre por një pjesë të asaj dhimbje ta kalojnë duke përmbushur ne detyrimin tonë financiar.

Një shumë prej 60 milionë lekësh shkon në duart e prindërve të të ndjerit. Duke bërë të mundur për ne përmbushjen e detyrimit një javë pas ndodhjes së aksidentit. Dhe natyrisht familjes për ti krijuar një lehtësim në dhimbjen që ata kanë”, tha ndër të tjera Ponari.

Në fund, nuk mungoi edhe një sensibilizim për të gjitha kompanitë në Shqipëri.

“Unë sot, këtu nga Martaneshi, i bëj thirrje të gjithë kompanive kudo që ndodhen, siç bëri kompania ku punonte djali i Muharremit, të tregojnë kujdes për punonjësit e tyre. Të bëjnë sigurimin nga aksidentet, të bëjnë sigurimin e jetës. Ky lloj sigurimi sot është domosdoshmëri për çdo njeri, për çdo kompani”.

Takimi me përfaqësues të “UN Women” në Shqipëri/ SIGAL UNIQA, e para kompani sigurimi që firmos “Parimet e Fuqizimit të Grave”

Drejtues të SIGAL UNIQA Group Austria pritën në një takim përfaqësues të UN Women në Shqipëri.



Gjatë takimit, Z.Avni Ponari, CEO i “SIGAL UNIQA Group Austria”, u shpreh se kompania që ai drejton po krijon në vazhdimësi një mjedis pune ku të gjithë individët mund të shprehin më të mirën e aftësive të tyre, duke inkurajuar fuqizimin e grave në të gjitha kompanitë e Grupit dhe duke u kujdesur që kontributi i tyre të vlerësohet siç duhet.

Ndërkohë ai ritheksoi angazhimin e tij për të ndërmarrë hapa më të mëdhenj dhe më të shpejtë për fuqizimin e grave në vendin e punës dhe në komunitet.

Z.Ponari vuri në dukje në mënyrë specifike kuotat e grave dhe pozicionet e tyre në hierarkinë e Grupit “SIGAL UNIQA”, i cili vepron jo thjesht si lider i tregut të sigurimeve por edhe si një model në sektorin privat të biznesit për Fuqizimin e Grave.

“Si CEO i “SIGAL UNIQA Group Austria”, jam i përkushtuar në zbatimin e politikave që forcojnë pozicionin e gruas në kompani. Jam i lumtur të pohoj se, aktualisht numri i grave në administrën e SIGAL UNIQA e ka tejkaluar atë të burrave duke përbërë 51.3% të totalit.

Ndërsa në nivel menaxherial numri i tyre arrin në rreth 42% me premisa për tu rritur akoma më tej në të ardhmen. Ne besojmë fort se, barazia gjinore nuk është vetëm një impenjim moral për kompaninë, por edhe një strategji

biznesi.

Z.Ponari shtoi më tej se, praktikatat e qeverisjes korporative të SIGAL UNIQA bazohen në standardet ndërkombëtare dhe udhëhiqen nga vlerat për të cilat Grupi është zotuar, në mënyrë që të garantojnë drejtësi dhe qëndrueshmëri në të gjitha hapat e ndërmarrë.

Përfaqësuesi i “UN Women” në Shqipëri, Michele Ribotta, u shpreh i kënaqur për takimin me drejtues të kompanisë ndërsa i falenderoi këta të fundit për faktin se Parimet e Fuqizimit të Grave janë pjesë përbërëse e vlerave të SIGAL UNIQA dhe se ato zbatohen në punën e përditshme të kompanisë, në të trija shtetet ku ajo operon, Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

“Parimet e Fuqizimit të Grave ofrojnë një mundësi për SIGAL UNIQA dhe sektorin financiar në Shqipëri për të udhëhequr me shembuj në promovimin e fuqizimit të grave në ekonomi. Kur gratë kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të komunitetit të tyre, në fund të fundit përfitojnë të dyja gjinitë dhe shoqëria në përgjithësi”, tha ndër të tjera Ribotta.

Më pas z.Ponari dhe z.Ribotta firmosën edhe “Parimet e Fuqizimit të Grave” me SIGAL UNIQA që bëhet e para kompani sigurimi që ndërmerr një hap të tillë.

Shtimi i sëmundjeve kancerogjene/ Ponari: Me SIGAL UNIQA, shërbime në klinikat dhe spitalet më të mira në botë

Edhe për shkak të COVID-19 dhe pasojave që la pas, numri i rasteve me kancer në Shqipëri, ashtu si në të gjithë botën, po njih vetëm rritje, duke mos kursyer as moshat e reja.

Në Shqipëri regjistrohen mbi 7000 raste të reja me kancer çdo vit duke bërë që përveç presionit psikologjik për tu përballur me sëmundje të tilla, qytetarët të përballen edhe me shpenzime të mëdha financiare.

Sepse kurimi i sëmundjeve kaq serioze kërkon shumë para.

Por ka gjithmonë një dritare shprese.

Në një intervistë për Top News, CEO i kompanisë më të madhe të sigurimeve SIGAL UNIQA, e njohur për produktet e saj unike në sigurimet shëndetësore, Avni Ponari na njih me atë çfarë ofron kompania që ai drejton në luftën kundër sëmundjeve tumorale, "Sigurimi anti-Tumor" dhe "Jetë Plus".

"SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA një nga kompanitë më të mëdha në rajon, ka kohë që ka nxjerrë në treg produkte që janë shumë të rëndësishme.

Ne nuk parandalojmë sëmundje, ne e mjekojmë dhe e kurojmë në metoda më të mira të sotme botërore dhe shkencore.

Mendoj që është moment i rëndësishëm që çdo qytetar shqiptar t'ju drejtohet zyrave të SIGAL kudo ku ndodhet, edhe online e të ketë këtë lloj sigurimi që është shumë i rëndësishëm", u shpreh ndër të tjera Ponari.



Por nuk duhet harruar as "Opinion i Dytë Mjekësor", një shërbim që e ofron vetëm SIGAL UNIQA dhe që është shumë i rëndësishëm për trajtimin e sëmundjes pasi mund t'ju japë përgjigje të qarta mbi gjendjen tuaj shëndetësore në mënyrë që edhe mjekët ta kenë më të lehtë kurimin.

Opinion i Dytë Mjekësor, i aplikueshëm në 60 shtete, bën të mundur që klientët e SIGAL UNIQA të marrin shërbime në spitalet dhe klinikat më të mira të 152 shteteve të ndryshme, në 5 kontinente.

Ky shërbim u mundëson klientëve të SIGAL UNIQA të marrin trajtimet e duhura në spitalet më të mira në Europë dhe jo vetëm, mes të cilëve mund të përmendim:


- Humanitas Research Hospital në Milano, Itali
- Spitali Rudolffinerhouse në Vjenë, Austri
- Spitali Confraternitaet në Vjenë, Austri
- Spitali Memorial në Stamboll, Turqi
- Harvard Medical School, në SHBA
- Baylor University, Medical Center në Dallas, SHBA
- Cleveland Clinic, në Cleveland, SHBA
- Insitute of Oncology, në Barcelonë, Spanjë

SIGAL UNIQA LIDERE E TREGUT TË SIGURIMEVE


SIGAL UNIQA
UNIQA GROUP AUSTRIA



Ndarja e Tregut të Sigurimeve të Jo-Jetës Maj 2024



Ndarja e Tregut të Sigurimet e Jetës Maj 2024



Burimi: Raporti Statistikor i Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare

SIGAL UNIQA, më e madhja dhe më e besuara kompani sigurimi edhe për 5-mujorin 2024

Në sigurimet e jetës dhe të jo-jetës; në sigurimet e detyrueshme dhe vullnetare; në sigurimet motorike; në sigurimet e pasurisë dhe të shëndetit...

SIGAL UNIQA Group Austria vijon të jetë emri më i madh dhe më i besuar i sigurimeve në Shqipëri edhe për periudhën janar-maj 2024.

Sipas raportit të publikuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF), kompania që është pjesë e “UNIQA Insurance Group” kryeson tregun e sigurimeve, si në primet

e shkruara ashtu edhe në dëmet e paguara.


Në Sigurimet e Jo-Jetës SIGAL UNIQA zë mbi 27% të totalit të tregut ku operojnë 8 kompani, ndërsa në ato të Jetës ku operojnë 4 kompani SIGAL LIFE UNIQA zë mbi 41% të tij.

Sa i përket ndarjes së tregut, në të detyrueshme dhe vullnetare, SIGAL UNIQA ruan lidhësin me konkretisht 21 dhe 37%.

Pensionet private pranë kufirit të 40 mijë anëtarëve/ “SIGAL UNIQA Fond Pensioni”, më i madhi sa i përket aseteve neto



VLERA E ASETETEVE NETO NË FONDET E PENSIONIT (NË %)



*Shënim: Të gjitha të dhënat u morën nga publikimi i faqes zyrtare të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF)

Tregu i pensioneve private vullnetare u rrit më tej në tremujorin e parë të këtij viti. Të dhënat e nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) tregojnë se tregu po i afrohet kufirit të 40 mijë anëtarëve.

Gjatë tremujorit të parë të vitit, numri i anëtarëve të fondeve arriti në 39,910 anëtarë, në rritje me 4.53% që nga fillimi i këtij viti dhe me 7.9% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Megjithatë, kjo rritje vjen mbi një bazë të ulët dhe depërtimi i këtyre skemave ngelet ende shumë modest.

Numri i individëve që kontribuojnë për një pension privat mbetet në afërsisht 3% të numrit të përgjithshëm të të punësuarve në vend, çka tregon një nivel ende shumë të ulët të mbulimit me fonde private të pensioneve.

Sipas raportit, gjatë periudhës janar-mars 2024, në tregun e pensioneve private ushtruan aktivitetin e tyre 6 fonde pensioni me një total asetesh neto prej 7,019.85 milionë lekë (68.24 milionë euro) dhe me një rritje prej 282 milionë lekë (4.18%) krahasuar me 31.12.2023.

Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve, deri më 31.03.2024 rezulton 39,910 anëtarë dose 1.730 më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë.

Sa i përket numrit të anëtarëve, Credins Pension mbetet në krye me afro 48% të totalit, e ndjekur nga SIGAL UNIQA Fond Pensioni me 31%.


Për nga vlera e aseteve neto, fondi më i madh mbetet “SIGAL UNIQA Fond Pensioni” duke zënë 41% të totalit të tregut ose e përkthyer në shifra 2,865,668,319 lekë.

SIGAL UNIQA – Kosovë, lidere e tregut të sigurimeve edhe për 5-mujorin 2024

BQK - Buletini statistikor
Pozicioni në treg Nr. 1

Primet e Shkruara Bruto nga
Kompanitë e Sigurimit të Jo-Jetës

Janar-Maj 2024



Sipas raportit më të fundit nga BQK, mbi tregun e sigurimeve në Kosovë për periudhën Janar - Maj 2024, SIGAL UNIQA Group Austria vijon të jetë kompania më e madhe dhe më e besuar.

SIGAL UNIQA zotëron 16.22% të tregut të sigurimeve të Jo-Jetës, ku operojnë 10 kompani.

Në janar-maj 2023, SIGAL UNIQA numëronte 7,795 milionë Euro prime, ndërsa në janar-maj 2024 numëron mbi 10,4 milionë euro prime të shkruara. Shifra këto që tregojnë besimin në rritje nda kompanisë.

Gjatë 5 muajve të parë të vitit SIGAL UNIQA ka paguar 12,845 dëme me vlerë rreth 3,3 milionë Euro.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA – Kosova u themelua në tetorin e vitit 2003 në kuadër të ndërkombëtarizimit të aktivitetit të SIGAL sh.a, përmes blerjes së një kompanie ekzistuese të sigurimeve.

SIGAL UNIQA Group Austria – Kosova u

licensua nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës si kompani e sigurimit të përgjithshëm të jo-jetës, ndërsa në vitin 2011 do të themelohej edhe SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA, si kompani e sigurimit të jetës.

Sot pas më shumë se 20 vjetësh, SIGAL UNIQA Group Austria Kosovë është kompania lider e sigurimeve, si për pozicionin që zë në treg ashtu edhe për dëmet e paguara tek klientët e saj.

Grupi “SIGAL UNIQA” numëron rreth 1,5 milionë klientë duke u shndërruar në një grup rajonal sigurimesh.

Me 8 kompani sigurimi Jetë dhe Jo-Jetë, Risigurime dhe Fond Pensionesh, “SIGAL UNIQA” është kompania e vetme që ofron të gjitha klasat e sigurimit dhe është çdo ditë pranë klientëve të saj me rreth 2,200 punonjës dhe agentë, dhe mbi 1,200 zyra në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut por pa harruar edhe platformën “SIGAL ONLINE”.

MAQEDONI E VERIUT

Sigurimet jo-jetë në Maqedoninë e Veriut rriten me 10%. Sigurimi privat i shëndetit, më popullori



Edhe në 5-mujorin e parë të këtij viti, sigurimi më popullor në Maqedoninë e Veriut mbetet sigurimi privat i shëndetit, ndërsa rritje të konsiderueshme ka Sigurimi KASKO.

Gjatë periudhës janar-maj 2024, primet kanë kaluar vlerën e 5,5 miliardë denarëve (89,6 milionë euro) në rritje me 10% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, tregojnë të dhënat zyrtare të dorëzuara pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve nga kompanitë e sigurimeve jo-jetë.

Në 5 muaj kompanitë kanë paguar 1,95 miliardë denarë (31,7 milionë euro). Vlera e dëmeve të paguara është 6% më e lartë se një vit më parë.

Nga sigurimet vullnetare, produkti më i kërkuar dhe me rritje më të shpejtë vazhdon të jetë sigurimi privat i shëndetit ku në 5 muajt e parë janë arkëtuar 687,7 milionë denarë prime (11,2 milionë euro).

Në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, primet sigurimet e shëndetit janë rritur për 35%.

Rritje është shënuar edhe në Sigurimin KASKO. Kompanitë e sigurimeve, për pesë muaj, kanë arkëtuar prime me vlerë 543 milionë denarësh (8,83 milionë euro), që është 17% më shumë se 5-mujori 2023.

Ndërkohë, sigurimi më i madh vullnetar, sipas vëllimit të primeve, mbetet sigurimi i pasurisë.

Qytetarët, institucionet dhe kompanitë kanë investuar gjatë këtij 5-mujori për sigurimin e pasurisë 1,22 miliardë denarë (19,82 milionë euro). Sa i përket sigurimit të detyrueshëm motorik, TPL, në pesë muajt e parë kompanitë kanë arkëtuar 2,21 miliardë denarë prime (36 milionë euro), 7% më shumë se një vit më parë.

Gjatë kësaj periudhe, kompanitë e sigurimeve në Maqedoninë e Veriut kanë lidhur mbi 676 mijë kontrata sigurimi.

Shumica prej tyre, mbi 305 700, janë lidhur për sigurimin nga aksidentet, produkt i destinuar për sigurimin kolektiv të punonjësve dhe nxënësve dhe që mbulon dëmtimet në ose jashtë vendit të punës apo shkollës.

Pikë historike për “UNIQA” Mbi 1 miliard Euro prime në sigurimin e korporatave në Europë



Që nga fillimi i saj, në 2011, “UNIQA Corporate & Affinity Business” ka përjetuar rritje të konsiderueshme. Ndërsa vitin e kaluar, grupi austriak i sigurimeve arriti një moment historik duke arkëtuar 1 miliard € prime të shkruara bruto.

“Si pjesë e strategjisë sonë B2B, ne jemi të përkushtuar të zgjerojmë dhe përmirësojmë ofertat tona gjithëpërfshirëse të shërbimeve 360 gradë për klientët e korporatave, duke synuar të bëhemi siguruesi kryesor i korporatave në tregjet e Evropës Qëndrore dhe Lindore”, shprehet Wolfgang Kindl, anëtar i bordit drejtues dhe kreu i Customer & Markets International në “UNIQA”.

“Me përvojën dhe njohuritë e mëdha që

kemi në ekipin tonë, kombinuar me aplikacionet teknike dhe dixhitale, ne jemi në gjendje të ofrojmë shërbime dhe zgjidhje unike për të gjithë klientët e korporatave”, thotë Olivera Boehm-Rybak, Kryeshf për Korporatat dhe Afinitetit Ndërkombëtar.

“Ne në UNIQA, e kuptojmë se çdo kompani është unike, ndaj ofrojmë zgjidhjet e nevojshme, që i përshtaten çdo klienti. Fokusi ynë në shërbimin ndaj klientit na dallon, ndërsa jemi të përkushtuar të ofrojmë produkte dhe shërbime inovative që i ndihmojnë klientët tanë të arrijnë sukses”, vijon Böhm-Rybak.

Ky është sukcesi i rradhës për “UNIQA Insurance Group” pasi një ditë më parë ishte prestigjozja “Standard & Poors” që rikonfirmoi vlerësimin me “A”.

'Spitali vjen tek ju'

SIGAL UNIQA i mundëson mbi 500 punonjësve të kompanisë në Tiranë kryerjen e Check Up-it në ambjentet e punës

Nëse një punonjës, që ju si punëdhënës e paguani mirë, e vlerësoni dhe i keni ofruar rritje profesionale, por pavarësisht kësaj një ditë ai ose ajo vjen tu paraqesë dorëheqjen, sepse preferon të jetojë jashtë vendit, cili do të ishte reagimi juaj? A e pyesni veten pse ndodh kjo gjë? A e keni menduar ndonjëherë se, një individ me të tilla mundësi, sërish nuk arrin të gjejë siguri në Shqipëri, përfshirë edhe atë shëndetësore?

Me rritjen e kostove të kujdesit shëndetësor, aksesit në shërbime shëndetësore bëhet i vështirë, e si rrjedhim punonjësit nuk vizitohen as kryejnë ekzaminime e si rrjedhim zbulojnë vonë sëmundjet dhe fuqia puntore bie. Dhe këtu, përveç shtetit, i cili duhet të luajë rolin e rregullatorit, një rol të rëndësishëm kanë edhe punëdhënësit.

Dhe reagimi i tyre për kujdesin që i ofrojnë punonjësve ka filluar tashmë.

Duke nisur që dita e djeshme e në vazhdim, mbi 500 punonjësit e një kompanie private në Shqipëri po kryejnë analizat e mësipërme si pjesë të Check Up-in vjetor në vendin e tyre të punës, pa patur nevojë të paraqiten në një spital apo klinikë private.

SIGAL UNIQA mundësoi që në ambjentet e kompanisë të shkonte një staf profesionistësh nga një spital privat në Tiranë për të kryer çdo analizë dhe ekzaminim të nevojshëm që kërkon një Check Up.

Ky përfitim ishte pjesë e paketës së sigurimit shëndetësor privat që kjo kompani ofron prej vitesh për punonjësit e saj në formë bonusi.

Garantimi i shëndetit të punonjësve është thelbësor për disa arsye:

Përfitimet për punonjësin

Në shumë raste, punonjësit zgjedhin të mos tregojnë kujdes parandalues ndaj problemeve të mundshme shëndetësore për shkak të radhëve të gjata, burokracive, apo për mungesë kushtesh në spitalet publike.



Polica e sigurimit privat të shëndetit është një përfitim i madh, veçanërisht për ata që nuk përballojnë dot ekonomikisht shtrimet emergjente në spital, aq më shumë që përfshin kontrollin vjetor dhe shërbime të tjera.

Kjo paketë u mundëson atyre trajtim preferencial në klinikat dhe spitalet më të mira, duke i bërë ata të ndihen edhe më të vlerësuar. Përfitimet për punëdhënësin

Çdo biznes ka nevojë për profesionistë të kualifikuar që zhvillojnë dhe çojnë përpara kompaninë.

Pavarësisht se sigurimi i shëndetit mund të mos jetë arsyeja kryesore që një punonjës të zgjedhë të punojë në kompaninë tuaj, pa dyshim është një nga arsyet më të rëndësishme për qëndrimin afatgjatë.

Diçka e tillë garanton edhe investimin tuaj.

Por mos harrojmë që shëndeti i mirë i punonjësve rrit performancën e kompanisë dhe ju bën punëdhënës të besueshëm.

Ndaj, nëse ende punonjësit e biznesit tuaj nuk e kanë ende një sigurim shëndeti, shkruani tani për të marrë një ofertë:

Whatsapp: 068 60 62 829

E-mail: infoshendet@uniqa.al

Specialistët e SIGAL UNIQA do të jenë të gatshëm t'ju ndihmojnë në çdo moment.

Sigurimi Privat i Shëndetit

Sigurimi privat i shëndetit është mundësi për mbulim të kostove financiare në rast aksidenti apo sëmundje të papritur.



Çfarë mbulon Sigurimi Privat i Shëndetit?

PARANDALIM

- ✓ Check up mjekësor në spitale private;
- ✓ Diagnostikim për të gjitha kontrollet mjekësore me rekomandim të mjekut specialist;
- ✓ Kujdes për shikimin dhe dhëmbët;
- ✓ Konsulta Online me mjekun 24/7.

TRAJTIM MJEKËSOR

- ✓ Çdo faturë spitalore në rast shtrimi në spital privat brenda dhe jashtë vendit;
- ✓ Ilaçet e rekomanduara nga mjeku;
- ✓ Trajtimi i sëmundjeve të rënda, si psh, tumori malinj nga diagnostikimi deri në trajtimin me kemioterapi, radioterapi apo imunoterapi;
- ✓ Shpenzimet në rast pandemie.

ASISTENCË

- ✓ Opinion i dytë mjekësor nga qendra mjekësore të specializuara në çdo vend të botës për diagnozën;
- ✓ Gjetja e mjekut më të mirë;
- ✓ Pagesa e biletës së avionit dhe akomodimit në hotel për pacientin dhe një të afërm që e shoqëron.

TRANSPORT MJEKËSOR

- ✓ Transporti me ambulancë rrugore apo ajrore në rast se i siguruari nuk mund të transportohet si pasagjer.

REHABILITIM

- ✓ Çdo faturë spitalore për fizioterapi.



Apliko online duke skanuar barkodin

Kush mund të sigurohet?

Çdo individ 0 - 64 vjeç i cili është në gjendje të mirë shëndetësore.

SIGAL UNIQA, pjesë e Panairit të Parë dedikuar Real Estate-t



Ndërtimi dhe sektori i pasurive të paluajtshme po rriten me hapa të mëdhenj por nga ana tjetër, edhe rreziqet që çënojnë këto sektorë veçanërisht janë rritur gjithashtu.

Doni ti ofroni klientëve tuaj një apartament, shtëpi apo vilë të sigurtë dhe të mbrojtur nga çdo e papritur? Jeni në vendin e duhur. Kompania më e madhe e sigurimeve “SIGAL UNIQA Group Austria” ishte pjesëmarrëse në Panairin e parë dedikuar Real Estate-t, “Global Real eXtate Fair”, i cili u mbajt në ambjentet e Piramidës së Tiranës në datat 12, 13, 14 qershor.

Çdo biznes që operon në tregun e Real Estate u mirëprit në stendën e “SIGAL UNIQA” për tu informuar nga afër me çdo produkt sigurimi që ajo ofron dhe mundësitë e bashkëpunimit.

Pse sigurimin e çdo pasurie duhet t’ja besoni SIGAL UNIQA-s?

Emër i madh: SIGAL UNIQA është një grup

– rajonal sigurimesh, i themeluar në shkurt 1999 dhe që operon në Shqipëri, Kosovë e Maqedoninë e Veriut.

– Pjesë e “UNIQA Insurance Group”: Prej vitit 2007 SIGAL UNIQA është pjesë e një grupi austriak sigurimesh, me një aktivitet mbi 200-vjeçar, i shtrirë në 17 shtete të ndryshme të Europës dhe i vlerësuar me “A” nga “Standard & Poors”

– Mbrojtje e plotë: Sigurimet nga SIGAL UNIQA ofrojnë mbrojtje nga çdo rrezik që mund të pronën apo çdo investim tuajin

– Parandalim dhe këshilla: Ekipet e ekspertëve të SIGAL UNIQA janë të gatshme për të ofruar udhëzime dhe këshilla për të parandaluar dëmet dhe për të punuar me efikasitet.

– Kostot e papritura: Me sigurimet në SIGAL UNIQA, ju mund të parashikoni më mirë kostot dhe të shmangni shpenzimet e papritura që vijnë si pasojë e rreziqeve të papritura.

FOTO/ Punonjësit e SIGAL UNIQA, fushatë pastrimi në bregdet

Punonjësit e SIGAL UNIQA Group Austria vazhdojnë traditën e përvitshme në pastrimin e plazheve në vend.

Pas Ditës Botërore të Mjedisit dhe në vigjilje të fluksit turistik, punonjësit e dy degëve të kompanisë në Shkodër dhe dy degëve në Durrës ishin në plazhin e Velipojës dhe të vijës bregdetare nga Shkëmbi i Kavajës me drejtim Golemin. ku për orë me rradhë pastruan zonat më problematike.

Në politikat e saj, SIGAL UNIQA gjithmonë ka mbështetur nismat në dobi të mjedisit pasi për kompaninë më të madhe të sigurimeve në Shqipëri është shumë i rëndësishëm raporti harmonik midis veprimtarisë së përditshme dhe kujdesjes ndaj ambientit.

Prej disa vitesh tashmë SIGAL UNIQA ofron edhe mundësinë e blerjes online të çdo siguracioni në mënyrë që të reduktohet sa më shumë përdorimi i letrës dhe ndikimi në mjedis të jetë sa më minimal.

Kjo fushatë, që synon edhe sensibilizimin e qytetarëve për ta mbajtur sa më pastër ambjentin, do të vijojë edhe në zona të tjera të Shqipërisë.



KOSOVË

Dita Botërore e Mjedisit



Në shënimin e Ditës Botërore të Mjedisit, stafi i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA - Kosovë morën pjesë vullnetarisht në aksionin “Ta pastrojmë Brezovicën”, në kuadër të organizatës Let’s Do It - Ta pastrojmë Kosovën. Në këtë iniciativë, u mbledhën qindra thasë me mbeturina dhe u pastruan rrugët e Brezovicës.

Dita Botërore e Mjedisit është një mundësi për të reflektuar mbi ndikimin tonë mjedisor dhe për t’u angazhuar për të bërë zgjedhje të qëndrueshme që do të ndihmojnë në ruajtjen e planetit tonë për brezat e ardhshëm.

Falenderojmë të gjithë anëtarët e ekipit për përkushtimin dhe kontributin e tyre në këtë kauzë të rëndësishme. Gjithashtu, falenderojmë organizatën Let’s Do It - Ta pastrojmë Kosovën dhe të gjitha institucionet tjera të rëndësishme për organizimin, bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në këtë aksion të përbashkët.

Sigurimi Kasko

Mbrojtja maksimale për makinën tuaj

Kasko është sigurimi vullnetar i mjetit motorik për dëmet e shkaktuara vetë mjetit motorik nga rreziqet e parashikuara në kontratë dhe të përzgjedhura nga vete klienti.



Pse të siguron makinën me Kasko tek SIGAL UNIQA?

Nëse jeni duke kërkuar sigurimin e duhur për makinën tuaj, i cili do t'ju mbroj financiarisht nga shumë ngjarje, atëherë zgjidhni KASKO nga SIGAL UNIQA.

- ✔ Shërbim i shpejtë dhe cilësorë
- ✔ Vlerësim profesional
- ✔ Garanci shërbimi në servise profesionale

Ofertat e SIGAL UNIQA për Sigurimin Kasko?

- ✔ Kasko e shoqëruar me Shërbimin "SIGAL UNIQA AutoSOS"
- ✔ Kasko e shoqëruar me TeleShëndet

Çfarë mbulon?

Produkti më i shitur

Rreziqet e Siguruara	1 Opsioni	2 Opsioni	3 Opsioni	4 Opsioni	5 Opsioni
1. Dëmtime aksidentale	✔	✔	✔	✔	✔
2. Thyerja e xhamave	✔	✔	✔	✔	✔
3. Zjarr, Rrufe, Eksplozion	✔	✔	✔	✔	
4. Katastrofat natyrore	✔	✔	✔	✔	
5. Vjedhja totale	✔	✔	✔		
6. Vjedhja e pjesshme	✔				
7. Dëmtim në parkim	✔	✔	✔	✔	✔
8. Akte keqdashëse	✔	✔			
9. AutoSOS	✔	✔	✔	✔	✔
10. GPS	✔	✔	✔		

Nëse klienti përzgjedh sigurim Kasko edhe për qarkullim jashtë Shqipërisë, atëherë çdo mbulimi rreziku i përzgjedhur për qarkullim brenda Shqipërisë është i vlefshëm edhe për qarkullim jashtë Shqipërisë.





COPYRIGHT SIGAL UNQA 2024

Përmbajtja e këtij newsletter dhe të gjitha të drejtat e saj i përkasin kompanisë së sigurimeve SIGAL UNIQA Group Austria dhe përdorimi nga të tretë, pa autorizimin e SIGAL UNIQA nuk është e lejuar. Shpërndarja e këtij newsletter mund të bëhet vetëm nëpërmjet kanaleve zyrtare të kompanisë.